

Kush po kryen studimin e Talking Time[®] (Koha e të folurit / Koha e bisedës)?

*Talking Time në shqip përkthehet si 'Koha e të folurit' apo edhe 'Koha e Bisedës'. Në vazhdim ne do t'i referohemi këtij projekti kërkimor në gjuhën angleze, pra Talking Time.

Universiteti i Oksfordit, Kolegji Universitar i Londrës (UCL), dhe Instituti i Arsimit kanë zhvilluar Talking Time[®] dhe do të drejtojnë projektin bashkë me shkolla dhe çerdhe. Mentorët që punojnë për të mbështetur stafin në mjediset e çerdheve janë profesionistë me përvojë me fëmijët në vitet e hershme të vegjëlisë (fëmijët e vegjël). Një ekip nga Instituti Kombëtar i Kërkimeve Ekonomike dhe Sociale (NIESR), i mbështetur nga një ekip nga Qa Research, do të vlerësojë ndikimin e programit dhe do të hetojë aftësitë gjuhësore të fëmijëve. Ekipi Qa Research është mësuar të punojë me fëmijë të vegjël dhe do ta bëjë procesin një proces të lehtë dhe të qetë.

Çfarë informacioni do të mblidhet dhe si do të përdoret?

Për të ekzekutuar programin Talking Time[®] dhe për të vlerësuar ndikimin e tij, shkolla/çerdhja e fëmijës suaj do të ndajë të dhëna për fëmijën tuaj me ekipet kërkimore (NIESR, Universiteti i Oksfordit, UCL dhe Qa Research). Këto do të jenë të dhëna mbi emrin e fëmijës tuaj, datën e lindjes, gjininë, zhvillimin gjuhësor (duke përfshirë çdo nevojë shtesë të lidhur me gjuhën), numrin unik i nxënësit (UPN), të dhëna mbi t Early Years Pupil Premium (fondet që mund të merrni nga qeveria) dhe nëse flitet anglisht si gjuhë shtesë (gjuhë dytësore) (ne do t'ju pyesim edhe për gjuhët që flisni në shtëpi). Gjithashtu, pjesëmarrja e fëmijëve në seancat e Talking Time[®] do të mbahet shënim nga shkolla apo çerdhja dhe do t'ju jepet Talking Time për vlerësim. Këto të dhëna do të përdoren vetëm për të vlerësuar ndikimin e Talking Time si projekt.

Si pjesë e vlerësimit të këtij studimi, do të mblidhen pikët dhe regjistrimet audio nga vlerësimet individuale gjuhësore të fëmijëve. Pjesëmarrja në studim është vullnetare. Rezultatet e vlerësimit të gjuhës së fëmijës suaj nuk do të ndahen me shkollën/çerdhën ose me familjet. Të dhënave të mbledhura nga çdo fëmijë do t'ju jepet një kod në mënyrë që individët të mos jenë të identifikueshëm gjatë analizimit të këtij studimi. Për qëllime kërkimore, të dhënat e ofruara, së bashku me rezultatet nga vlerësimet gjuhësore do të lidhen me grupe të tjera të dhënash dhe do të ndahen me organizata të tjera. Detajet rreth kësaj pjese përcaktohen në 'deklarata e privatësisë' (shih më poshtë për më shumë informacione rreth 'deklaratës së privatësisë').

Do të mblidhen regjistrimet video të sesioneve të Talking Time dhe regjistrimet audio të grupeve të tregimeve. Pjesëmarrja në këto regjistrime është vullnetare. Ju mund të pranoni vetëm një lloj regjistrimi (audio ose video) ose të dyja. Nëse jepni pëlqimin për ndonjë nga aktivitetet e vlerësimit, ne do të kërkojmë nga ju të plotësoni dhe të dorëzoni formularët e miratimit (pra formularët që kërkojnë miratimin tuaj).

Mënyrat se si do të përdorim informacionin e mbledhur shpjegohet në deklaratën e privatësisë (shih kodin QR më poshtë). Dy raporte përfundimtare pritet të publikohen në verën e vitit 2026. Asnjë fëmijë apo mjedis individual nuk do të jetë i identifikueshëm në këto raporte ose në ndonjë publikim tjetër të projektit - të gjitha detajet do të jenë plotësisht anonime.

Kush e ka shqyrtuar hulumtimin e planifikuar?

Puna është shqyrtuar dhe ka marrë miratimin nga komiteti i etikës në NIESR (kodi i projektit NIESR EP30) dhe gjithashtu është miratuar nga një nënkomitet i Komitetit të Etikës së Kërkimit të Universitetit Qendror të Universitetit të Oksfordit: Referenca e etikës në Universitetin e Oksfordit: EDUC_C1A_24_011_Amendment_01.

Si mbrohet informacioni?



Ne j'u marrim shumë seriozisht ju dhe sigurinë e të dhënave të fëmijës suaj dhe do të punojmë ngushtë me shkollën/çerdhen e fëmijës suaj për të siguruar që të dhënat të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Të dhënat do të ndahen dhe përpunohen në përputhje me GDPR dhe Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave 2018.

Detajet e plota në lidhje me GDPR, palët e treta dhe konfidencialitetin jepen në deklaratat mbi privatësinë. Ju mund ta aksesoni atë nëpërmjet këtij linku [Njoftimi i privatësisë \(Prindërit\)](#) ose duke skanuar kodin QR.

Ju lutemi t'a lexoni atë me kujdes. Ju do të duhet të konfirmoni se e keni lexuar dhe kuptuar këtë informacion përpara se të vazhdoni.

Me kë të kontaktoj nëse kam pyetje...

Nëse keni ndonjë pyetje të përgjithshme në lidhje me programin e Talking Time dhe studimin e vlerësimit shoqëruar, ju lutemi mos ngurroni të kontaktoni ekipin e vlerësimit në TalkingTime@niesr.ac.uk ose duke telefonuar në 020 3948 4488. Ju gjithashtu mund të kontaktoni ekipin e Talking Time[®] nëpërmjet këtij emaili: talkingtime@education.ox.ac.uk

Nëse keni pyetje ose shqetësime se si përpunohen të dhënat tuaja ose dëshironi të ushtroni ndonjë nga të drejtat në lidhje me këtë projekt kërkimor, ju lutemi referojuni deklaratës së privatësisë që përmban të gjitha detajet përkatëse.

Nëse keni shqetësime për ndonjë aspekt tjetër të këtij aktiviteti /projekti, ju lutemi kontaktoni:

- Kontakti i NIESR: Edoardo Masset TalkingTime@niesr.ac.uk
- Universiteti i Oksfordit: Dr Sandra Mathers talkingtime@education.ox.ac.uk

Ne do të bëjmë çmos për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja. Ne do të pranojmë shqetësimin tuaj brenda 10 ditëve pune dhe do t'ju tregojmë se si do të trajtohet kërkesa apo shqetësimi juaj. Nëse mbeteni të pakënaqur ose dëshironi të bëni një ankesë zyrtare, ju lutemi kontaktoni:

- Ekipi i qeverisjes, etikës dhe sigurimit të Universitetit të Oksfordit (RGEA) në rgea.complaints@admin.ox.ac.uk ose në 01865 616480
- Komiteti i Etikës NIESR: Katharine Stockland d k.stockland@niesr.ac.uk



Education
Endowment
Foundation

